

VENDIM
Nr. 574, datë 3.10.2018

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK DHE ZVOGËLIMIN NË
VOLUM TË SIPËRFAQES PREJ 3.13 HA, QË DO TË PËRDORET NGA SHOQËRIA
“DORUZ” SHPK, PËR SHFRYTËZIMIN E MINERALIT RANOR-PLLAKOR NË
OBJKTIN “BREGU I KALLMIT”, BASHKIA SKRAPAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007, “Për fondin kullor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore publike prej 3.13 ha, që do të përdoret nga shoqëria “Doruz” sh.p.k., për shfrytëzimin e mineralit ranor-pllakor në objektin “Bregu i Kallmit”, Bashkia Skrapar, të hiqet nga fondi pyjor dhe kullor publik i bashkisë, të zvogëlohet në volum dhe të çregjistrohet nga Regjistrimi i Kadastrës së Pyjeve dhe Kullotave. Të dhënat për sipërfaqet pyjore që zvogëlohen në volum dhe hiqen nga fondi pyjor e kullor publik dhe koordinatat e poligonit të sipërfaqes, objekt mineral, janë sipas lidhjes dhe hartës topografike që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Vlerat përkatëse të volumit të materialit drusor, të produkteve të tjera pyjore e kullorore dhe të investimeve të kryera në vite në sipërfaqen, objekt mineral, paguhen nga shoqëria “Doruz” sh.p.k., në llogarinë rrjedhëse të Bashkisë Skrapar, në bazë të lidhjes 4, të vendimit nr. 391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “Doruz” sh.p.k., detyrohet të rehabilitojë sipërfaqet sipas kushteve të lejes mjedisore dhe të pyllëzojë, me fondet e veta, një sipërfaqe pyjore prej 3.13 ha, në ngastrat e përcaktuara në marrëveshje me Bashkinë Skrapar.

4. Bashkia Skrapar dhe shoqëria “Doruz” sh.p.k. nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Një kopje e marrëveshjes, së bashku me projektin e miratuar për pyllëzimin, të dërgohet në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë nga data e nënshkrimit të saj.

5. Sipërfaqet pyjore, sipas lidhjes bashkëlidhur këtij vendimi, mbeten pronë publike e shtetit dhe regjistrohen në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme bën çregjistrimin e sipërfaqes pyjore, të identifikuar, sipas lidhjes bashkëlidhur këtij vendimi nga kategoria “Tokë pyjore” dhe e regjistron në kategorinë “Tokë e zënë, objekt i aktivitetit mineral”.

7. Me përmbushjen e detyrimeve nga shoqëria “Doruz” sh.p.k., të përcaktuara në planin e rehabilitimit sipas lejes mjedisore, sipërfaqja e rehabilituar të regjistrohet në fondin pyjor dhe kullor publik të Bashkisë Skrapar.

8. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Skrapar, Bashkia Skrapar dhe shoqëria “Doruz” sh.p.k., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Bashkia SKRAPAR

LISTA E NGASTRAVE DHE N/NGASTRAVE TË FONDIT PYOR DHE KULLOSOR PUBLIK
QË HIQEN PËR KRYERJEN E AKTIVITETIT MINERAR TË SHOOËRISË "DORUZ" shpk

Nr.	ID Pronës	Ekonomia Pyjore/Kullosore	Ngastra n/ngastra	Sipërfaqja që hiqet nga fondi pyjor/ kullosor HA	Përdorimi territorit
1	2	3	4	5	
1	BR32 00 064a	Sijove-Guhak	64a	1.39	shkurre
2	BR32 00 065a	Sijove-Guhak	65a	1.74	shkurre
GJITHSEJ				3.13	


MINISTËR

Blendi KLOSI


MINISTËR

Damian GJIKNURI


PLANVENDOSJA E KUFJIVE TE LEJES MINERARE NR. 1768 DATE 21.09.2015 MBI HARTEN KADASTRALE PYJORE SLOVE GUAK
E DIXHITALIZUAR DHE GJEOREFERUAR SH. 1 : 10000



LEGJENDA:

KOORDINATAT DHE SPIRFAQJA E KARRIERES
QE DO HIQEN NGA FONDI PYJOR

KARRIERA E MINERALIT NDRITIMOR RANOR PILAKOR

PIKA	X	Y
1	44 81 090	44 38 585
2	44 81 350	44 38 575
3	44 81 400	44 38 560
4	44 81 445	44 38 937
5	44 81 090	44 38 869

SPIRFAQJA = 63 407 M²

NGA TE CLAT:

NGA PARCELA 65, a ZHEN = 17 424 m²

NGA PARCELA 64, a ZHEN = 13 947 m²

NGA PARCELA 64, b ZHEN = 32 036 m²

PROJEKTI

"STUDIO PROJEKT" SH.P.K

TIRANE

2017

OBJEKTI:

PROJEKTI I KARRIERES MINERARE NGA FONDI PYJOR

PROJEKTI I KARRIERES MINERARE NGA FONDI PYJOR

MINERARE NR. 1768, DATE 21.09.2015, QILJETI "BREGU I GJALMIT", QARKU BIRAT

FOROSIT:

"DORUZ" shp

KARRIERA E KUFJIVE TE LEJES MINERARE

MINERALIT NDRITIMOR RANOR PILAKOR

MINERALIT NDRITIMOR RANOR PILAKOR

DIXHITALIZUAR DHE GJEOREFERUAR

SH. 1 : 10000

GRUPI PROJEKTIMIT:

INZHINIER MINIERE

INZHINIER GJEOLG

INZHINIER MARKSHADER:

GJEOKRASHIER:

DATA:

2017

SKALA E DITIMIT:

1 : 10 000

EMRI I DITIMIT:

0-62

LEGJENDA:

- Kufi ngastira pyjore
- Kufi nen r'ngastira pyjore
- Emerim ngastira pyjore
- Emerim nen r'ngastira pyjore
- Kufi i lejes minerare
- Izolpse kryesore
- Izolpse ndihmese